



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:087279

Datë: 28.10.2024

Numri i dokumentit: 06367863

KA.nr.482/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Paditësi "IP KOS" sh.p.k., me seli në Gracanice, rr. "Pennsylvania", nr. 41 (Marigona Residence), me numer unik identifikues 810834673, i përfaqësuar sipas autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve "SCLR Partners" sh.p.k., me seli ne Prishtine, Soliteri Avalla P+ 12, kundër të paditurës Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (me parë ishte Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) Qeveria e Republikës së Kosovës, me seli ne Prishtine, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me kërkesë për anulimin Vendimit me nr.A-57/20 me datë 11.06.2020 dhe Vendimit Nr.07.Nr.353/04-244945/19 i datës 12.02.2020, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor më datë 10.10.2024, në prezencë të përfaqësueses së autorizuar te palës paditëse Gentiana Behluli, dhe të përfaqësueses së palës së paditur Fitore Byqmeti, më datë 28.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit "IP KOS" sh.p.k., me seli në Gracanice, me numer unik identifikues 810834673, kundër të paditurës Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Qeveria e Republikës së Kosovës.
- II. **ANULOHET** si i kundërligjshëm Vendimi i i të paditurës nr.A-57/20 me datë 11.06.2020 dhe Vendimi Komunës se Prishtines, me nr. 07 NR. 353/04-244945/19 të dates 12.02.2020, çështja kthehet tw paditurws në rishqyrtim dhe rivendosje.

III. **OBLIGOHET** e paditura që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 23.07.2020, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative paditësi "IP KOS" sh.p.k., me seli seli në Gracanice, rr. "Pennsylvania", nr. 41 (Marigona Residence), me numer unik identifikues 810834673, i përfaqësuar sipas autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve "SCLR Partners" sh.p.k., me seli ne Prishtine, Soliteri Avalla P+ 12, ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Qeveria e Republikës së Kosovës, me seli ne Prishtine, për shkak të heshtjes administrative, me propozimin gjykata të bjen aktgjykim më të cilin aprovohet në tërësi si e bazuar kërkespadi e paditësit "IP-KOS" sh.p.k., me seli ne Prishtine, per vendosje te objektit levizes (Kamp Shtëpizës), ne piken shitese/njesine punuese e cila ndodhet ne Prishtine, Rr. "UCK"-se, parcela kadastrale 6055-0 ZK Prishtinë, ose të detyrohet e paditura Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor brenda afatit ligjor te nxjerre vendim sipas ankeses së paditesit te dates 03.04.2020 e parashtruar kunder vendimit te Komunes se Prishtines, me nr. 07 NR. 353/04-244945/19 të dates 12.02.2020. Me parashtrësë të datës 06.08.2020 e ka zgjeruar kërkesëpadinë ndaj aktit të nxjerre ne procedurë administrative nga e paditura nr. A-57/20 me datë 11.06.2020, me propozim që vendimi të anulohet si I kundërligjshëm dhe çështja të kthehet ne rishqyrtim dhe rivendosje. Lënda është evidentuar me nr. A.1222/2020.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA nr. 482/22.

3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik, me datë 20.05.2024 dhe më datë 10.10.2024, në prezencë të përfaqësueses së autorizuar të palës paditëse Gentiana Behluli, dhe të përfaqësueses së palës së paditur Fitore Byqmeti.

Pretendimet e paditësit

4. Paditesi me date 04.10.2019 ka parashtruar në Komunen e Prishtinës - Drejtorinë e Urbanizimit "Kërkesë për lejimin e vendosjes së objektit levizës (Kamp Shtëpizës), në njësinë e saj punuese në Prishtinë, Rr. "UCK-se". Mirepo, Komuna e Prishtinës këtë kërkesë e ka refuzuar me arsyetimin se akoma nuk ka ndonjë dokument të planifikimit hapsinor në fugi, që do të përcaktojnë kriteret dhe kushtet për vendosjen e objekteve të kësaj natyre në qytet për lokacionin sipas kërkesës së paditesit.
5. Më datë 11.12.2019 paditesi ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të lartcekur në Komunën e Prishtinës - Drejtorinë për Urbanizim për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, përmes së cilës ankese ka kërkuar që të aprovohet ankesa dhe të detyrohet Komuna e Prishtinës që të aprovojë kërkesën e paditesit dhe ta pajis me leje për vendosjen e objektit levizës "kamp shtëpizës" në pikën në adresën rr. "UCK-s", sipas certifikatës së pronësive të emërtuar si rruga "Rexhep Luci".
6. Më tutje, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor pas pranimit të kësaj ankese ka marrë aktvendim Nr. A-03/20 të datës 15.01.2020 me të cilin ka obliguar Komunën e Prishtinës që të zhvillojë shqyrtime konform nenit 131 par. 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative
7. Pas pranimit të këtij vendimi, paditesi me datë 27.01.2020 ka parashtruar kërkesë për rifillimin e procedurës administrative lidhur me këtë qeshtëje. Kështu, Drejtoria për Urbanizim e Komunes së Prishtinës përsëri ka marrë vendim me nr. 07 NR 353/04/-244945/19 me të cilin vendim përsëri ka refuzuar kërkesën e paditesit për lejimin e vendosjes së objektit në fjalë, me arsyetimin se nuk ka ndryshuar asje rethanë për vendosjen ndryshe të kësaj qështjeje administrative.
8. Paditesi edhe kundër këtij vendimi të fundit të Drejtorisë së Urbanizimit ka parashtruar ankese pranë kësaj të fundit, ku me pas kjo Drejtori përmes Dokumentit "Dergese Dokumentacioni" të datës 12.05.2020 e ka përcjellur ankesën e paditesit për vendosje në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.

9. Mirëpo, e paditura me vendim Nr. A-57/20 me datë 11.06.2020 e ka refuzuar sit ë pa bazuar ankesën e paditësit dhe e ka lënë në fuqi vendimin e kundërshtuar. Në arsyetim të kërkeses për vendosje të objektit lëvizës (kamp shtëpizës), deklaroi se paditësi në pronën e marrë me qera nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka siguruar edhe pëlqimin e AKP-se, e cila përmes përgjigjes në kërkesë me nr. prot 2176/2020 të datës 21.01.2020, ka lejuar paditësin që të vendosë këtë objekt lëvizës (kamp shtëpizën) në pronën e marrë me qera nga AKP. Mirëpo, Komuna e Prishtinës ka vendosur të refuzoj kërkesën e paditësit me arsyetimin se nuk ka Dokument të Planifikimit Hapsinor për Komunën e Prishtinës, respektivisht për lagjen ku është njesia punuese në fjalë e paditësit.
10. Konsideron se një arsyetim i tillë i Komunës së Prishtinës ishte në teresi i pabazuar dhe absurd për faktin se e njëjta nuk ka Dokument për Planifikim Hapsinor për këtë pjesë të qytetit, ndërsa në anën tjetër Inspektoret e po kësaj komune dalin dhe i kërkojnë paditësit që të pajiset me pëlqim/leje për vendosje të këtij objekti lëvizës. Pra, i njëjti institucion (pra Komuna e Prishtinës) edhe kërkon që të pajisemi me leje dhe në të njëjtën kohë refuzon kërkesën se nuk ka Dokument të Planifikimit Hapsinor.
11. Me arsyetimin se nuk ka Dokument të Planifikimit Hapsinor, Komuna e Prishtinës ka shkelur në tërësi obligimet e saj që rrjedhin nga Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapsinor, respektivisht nën 5 par. 1 nën par. 1.2, 1.2.1, 1.2.2, 1.2.3, dhe nën 6 par. 1 nën par. 1.2, 1.2.1, 1.2.2. Komuna e Prishtinës ka shkelur këto dispozita ligjore për faktin se e njëjta si institucion përgjegjës për hartimin dhe miratimin e dokumenteve të Planifikimit Hapsinor nuk ka nxjerr dokumentet e nevojshme që rregullojnë këtë çështje dhe kështu në mënyrë arbitrare ka refuzuar kërkesën e paditësit. Komuna e Prishtinës ka shkelur edhe dispozitat e nenit 10 dhe 11 të të njëjtit Ligji për përgjegjësitë e Kuvendit Komunal në Planifikimin Hapsinor.
12. Prandaj, duke qenë se Komuna e Prishtinës nuk ka përmbushur obligimet e saj për nxjerrjen e dokumenteve të planifikimit hapsinor e njëjta nuk mundet e as nuk do të duhej të ndermerrte veprime arbitrare për të moslejuar vendosjen e objektit lëvizës të kërkuar nga paditësi. Për të kërkuar përmbushjen e një kushti siç kërkohej nga Komuna e Prishtinës marrja e lejes/pëlqimit duhet se pari ta rregullojë infrastrukturen ligjore për këtë çështje, që Komuna e Prishtinës asnjëherë nuk e ka bërë.

Kundërshtimet e të paditurës

13. Përfaqësuesi i të paditurës në përgjigje në padi të dorëzuar me datë 21.02.2024, ka deklaruar se e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, konsideron se vendimi i kundërshtuar është i drejtë, i bazuar në ligj dhe i përmban të gjitha elementet e një akti administrativ dhe arsye të mjaftueshme të cilat arsyetojnë dispozitvin e vendimit. I propozon gjykatës që kërkesë padinë dhe zgjerimin e saj ta refuzoj.

Provat e administruara

14. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Kërkesë për nxjerrjen e aktit administrativ nga paditësi drejtuar MMOH-së me nr.prot.770 me datë 07.08.2020, Kërkesë për plotësim të dokumentacionit me datë 27.01.2020 sipas kërkesës së paraqitur me datë 04.10.2019 drejtuar Komunës së Prishtinës, Procesverbal nga Drejtoria e Inspeksionit me nr.ref.007247 të realizuar tek paditësi IP KOS me datë 02.10.2019, Përgjigje nga AKP me datë 21.01.2020 drejtuar paditësit IP KOS, Ankesë e paditësit kundër vendimit 353/04-244945-19 me datë 19.08.2019 drejtuar MMPH-së, Vendim i Komunës së Prishtinës për refuzim të kërkesës 353/04-244945-19 me datë 04.10.2019, Vendim i MMPH-së me numër A03/20 me datë 15.01.2020, Vendimi me nr.A-57/20 me datë 11.06.2020.

Vlerësimi i gjykatës

1. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në kuptim të Neni 13 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative paragrafi 1 parasheh se *“Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë dhe pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi, kundërshtimeve sipas përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.*
2. Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Urbanizmit me vendimin me nr. 07 NR. 353/04-244945/19 të dates 12.02.2020 e ka refuzuar kërkesën e paditësi me arsyetim se nuk ka ndryshuar asnjë rrethane e cila do te ndikonte ndryshe ne vendosjen e kësaj çështje administrative, sepse Komuna e Prishtinës akoma nuk ka ndonje dokument te

planifikimit hapësinor ne fuqi, që do të përcaktonte kriteret dhe kushtet për vendosjen e objekteve të kësaj natyre ne qytet, për lokacionin sipas kërkeses së parashtruar. Rregullorja për Vendosjen, Ndertimin dhe Largimin e Objekteve të Perkohshme në Pronën Publike e rregullon vendosjen e objekteve të perkohshme vetëm në pronën publike. Neni 4, paragrafi 4.2, pika e, e ka kategorizuar si objekt të përkohshëm automjetin levizës për shitjen e ushqimit të shpejtë, mirëpo me nenin 7, paragrafi 2, është sqaruar se për këtë lloj objekti lejen e jep organi kompetent për shërbime publike, pasi që shfrytëzohet prona publike. Në rastin konkret meqenese prona nuk është publike Drejtoria e Shërbimeve Publike kërkesën e "IP KOS"SH.P.K e ka përcjelle në Drejtorinë e Urbanizmit. Komuna e Prishtinës gjithashtu e ka Rregulloren për procedurën e ndertimit të objekteve me karakter të perkohshëm në pronat e personave fizike dhe juridik, Nr. 01. nr. 110-288305, më 31.12.2014, mirëpo sipas nenit 8, paragrafi 1, kusht është që në parcele nuk duhet të këtë objekt të ndërtuar, e në rastin konkret në parcelën kadastrale 6055-0 Z.K Prishtinë është e ndërtuar pompa e derivateve.

3. Paditesi kundër këtij vendimit ka parashtruar ankese për vendosje në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, mirëpo, e paditura me vendim Nr. A-57/20 me datë 11.06.2020 e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe e ka lënë në fuqi vendimin e kundërshtuar, me arsyetim të njëjtë se nuk ka asnjë dispozitë ligjore në Rregulloren për procedurën e ndertimit të objekteve me karakter të perkohshëm në pronat e personave fizike dhe juridik, Nr. 01. nr. 110-288305, e cila do të ndikonte ndryshe në vendosjen e kësaj çështje dhe nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë.

4. Gjykata vlerëson se Vendimi Nr. A-57/20 me datë 11.06.2020 i të paditurës Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe e ka lënë në fuqi vendimin e kundërshtuar me arsyetim të njëjtë dhe Vendimi i Komunës së Prishtinës, Drejtoria e Urbanizmit me vendimin me nr. 07 NR. 353/04-244945/19 të datës 12.02.2020 është kontradiktor në kuptim të Nenit 48 të LPPA-së, par 2. ku përcaktohet *një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë,*

kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij, në kundërshtim me Neni 52 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit.

5. Sepse, arsyetimi se Komuna e Prishtines akoma nuk ka ndonjë dokument te planifikimit hapësinor ne fuqi, që do të përcaktonte kriteret dhe kushtet për vendosjen e objekteve te kësaj natyre ne qytet, për lokacionin sipas kërkeses se parashtruar është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme dhe joproporcionale nga e paditura dhe në kundërshtim me detyrimin ligjore që i janë përcaktuar me Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Neni 6 përcakton *Subjektet Përgjegjëse që ushtrojnë funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë përkatëse, që bazohen në legjislacionin në fuqi për çështje të planifikimit hapësinor: 1.1. në nivel qendror: 1.1.1 Kuvendi i Kosovës; 1.1.2 Qeveria e Kosovës; dhe 1.1.3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; dhe 1.2. në nivel lokal: 1.2.1. Kuvendi Komunal; dhe 1.2.2. autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor.*
6. Gjykata rikujton se është përgjegjësi ligjore dhe kushtetuese e Institucioneve të Republikës së Kosovës, respektivisht e Komunave në nivel lokal qe ti përmbushin detyrimet ligjore që i kanë në kuadër të kompetencave vetëqeverisëse dhe ti nxjerrin Dokumentet e Planifikimit Hapësinor ku përfshihen Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës dhe Plani Rregullues i Hollësishëm, siç përcaktohet në Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.
7. Gjykata konstaton se arsyetimi i refuzimit të kërkesës së paditësit rrjedh për shkak të dështimeve të institucioneve publike qoftë të nivelit qendror apo lokal në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe kushtetuese, prandaj të njëjtat nuk mund të marrin vendime arbitrare me arsyetim se nuk ka dokument te planifikimit hapësinor, në atë mënyrë që dështimin e tyre në përmbushjen e përgjegjësiave ligjore në kuadër të kompetencave të tyre ta faturojnë në llogari të qytetarëve apo shoqërive tregtare, duke ndikuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në të drejtë e shfrytëzimit dhe gëzimit paqësor te pronës - përmes uljes së vlerës ekonomike të pronës - si e drejtë univerzale e njohur me Kushtetutën dhe

ligjet e Kosovës, si dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

8. Prandaj gjykata vlerëson se vendimet e kundërshtuara Vendimi Nr. A-57/20 me datë 11.06.2020 i të paditurës Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe Vendimi Nr. 07 NR 353/04/-244945/19 i Komunës së Prishtinës me të cilin refuzohet kërkesa e paditesit për lejimin e vendosjes së objektit në fjalë, me arsyetimin se nuk ka Dokument të Planifikimit Hapsinor për Komunën e Prishtinës, është në kundërshtim me qëllimin e Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, për të siguruar një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, është në kundërshtim me Kapitullin X neni 123 dhe neni 124 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për të promovuar qeverisje të mirë dhe kushte të jetesës për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në kundërshtim me parimet e vetëqeverisjes lokale të Kartës evropiane të vetëqeverisjes lokale dhe protokollat e saj, si dhe në kundërshtim me obligimet e saj që rrjedhin nga nenin 5 par. 1 nën par. 1.2, 1.2.1, 1.2.2, 1.2.3, dhe nenin 6 par. 1 nën par. 1.2, 1.2.1, 1.2.2. i Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapsinor.
9. Përveç kësaj është edhe kontradiktore sepse në arsyetim thuhet se *Komuna e Prishtinës gjithashtu e ka Rregulloren për procedurën e ndertimit të objekteve me karakter të perkohshëm në pronat e personave fizike dhe juridik, Nr. 01. nr. 110-288305, më 31.12.2014, mirëpo sipas nenit 8, paragrafi 1, kusht është që në parcele nuk duhet të ketë objekt të ndërtuar, e në rastin konkret në parcelën kadastrale 6055-0 Z.K Prishtinë është e ndërtuar pompa e derivative, çka e bënë të paqartë arsyen për të cilën është refuzuar kërkesa: se a është refuzuar për shkak të mungesës së dokumentit të planifikimit hapësinor apo është refuzuar se nuk i plotëson kushtet sipas Rregulloreve për procedurën e ndertimit të objekteve me karakter të perkohshëm në pronat e personave fizik dhe juridik, Nr. 01. nr. 110-288305. Prandaj në kuptim të nenit 48 dhe 52 të LPPA-se vendimet e kundërshtuara janë të kundërligjshme dhe duhet të anulohen.*
10. Në procedurë të rishqyrtimit obligohet e paditura, respektivisht Komuna e Prishtinës, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe t'i mënjanoj të metat e vendimit kontestues, në atë mënyrë që: 1). ta shqyrtoj kërkesën e paditesit IP-KOS" Nr.07 Nr. 353/04-244945/19 dt. 04.10.2019, për lejimin e vendosjes së objektit levizes - kamp shtepizes, për përgatitjen e ushqimit të shpejte, me dimensione 5.8 x 2.37m, në parcelen

kadastrale 6055-0 Z.K Prishtine, 2).Ta konstatoj mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, 3). Në bazë të gjendjes se vërtetuar faktike ta vlerësoj se objekti a i plotëson kushtet për dhënjën e lejes sipas Rregullores per proceduren e ndertimit te objekteve me karakter te perkohshem ne pronat e personave fizike dhe juridik, Nr. 01. nr. 110-288305, më 31.12.2014, dhe atë pavarësisht se ekziston apo jo Dokumenti i Planifikimit Hapsinor per Komunën e Prishtines, sepse finalizimi i Dokumentit të Planifikimit Hapsinor është përgjegjësi e Komunës prandaj nuk mund të merret si bazë në asnjë mënyrë për refuzim të kërkesës së paditësit.

11. Bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi për shpenzimet procedurale u more në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.482/22, datë 28.10.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.